

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Katedra Civilo-Juridike, Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Kompanive
Niveli:	Master - E Drejta Civile dhe Pronësore
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	3+0
Vlera në kredi – ECTS:	3 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësit e lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Valbon Mulaj
Detajet kontaktuese:	valbon.mulaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>E Drejta e Kompanive është lëndë zgjedhore në semestrin e parë (semestrin dimëror), me fond javor të orëve mësimore (tri orë ligjërata), me gjithsej tri kredi.</p> <p>E Drejta e Kompanive ofron njohuri teorike dhe praktike për të drejtën e kompanive. Nga njohuritë e fituara në këtë lëndë, studentët do të zotërojnë dije për të këshilluar palët, të jenë të aftë të themelojnë dhe të menaxhojnë një kompani, si dhe të përfaqësojnë kompanitë në tregun nacional dhe evropian.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi kryesor i lëndës është pasqyrimi i arritjeve kulturore në fushën e analizave teorike dhe praktike dhe të zgjedhjes së modeleve më të dobishme dhe më të avancuara të kompanive të një vendi. Më tutje, nëpërmjet njohurive në këtë lëndë, synohet përgatitja adekuate dhe e plotë e studentëve të studimeve master të Drejtësisë, për t'u përballur me sukses me kërkesat, nevojat dhe sfidat e tregut të dijes në fushat, degët dhe disiplinat e ndryshme shkencore, që bëjnë pjesë direkt apo indirekt në sistemin e të drejtës së kompanive vendëse dhe evropiane.</p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet njohurive të fituara në këtë lëndë, studentët do të zotërojnë aftësi për të trajtuar aspekte praktike të të drejtës së kompanive, duke përfshirë temat e qeverisjes korporative, rregullimin e raporteve midis aksionarëve dhe strukturave menaxhuese, si dhe trajtimin e aksioneve si interes pronësor.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Lënda: E Drejta e Kompanive do të t'u ofrojë studentëve njohuri të reja dhe të përshtatshme për kërkesat që ka tregu. Në përfundim, studentët duhet të jenë të aftë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. të kenë njohuri mbi llojet e kompanive, të cilat njihen sipas legjislacionit të Kosovës;

	<ol style="list-style-type: none"> 2. të kenë njohuri për llojet dhe modelet e kompanive të njohura të legjislacioneve të tjera (kryesisht në Bashkimin Evropian) dhe të krahasimit të tyre me ato të Kosovës; 3. të kuptojnë modelet e qeverisjes së kompanive të ndryshme, me fokus të veçantë në Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe Shoqëritë aksionare; 4. të kuptojnë dokumentet kryesore për themelimin dhe qeverisjen e kompanive, duke përfshirë Statutin, Memorandumin e Inkorporimit; 5. të jenë të aftë të draftojnë dokumente të themelimit të kompanisë dhe të finalizojnë regjistrimin në organet publike në Republikën e Kosovës; 6. të jenë të aftë të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjet e aplikueshme për kompanitë në Kosovë dhe të aplikueshme sipas direktivave të Bashkimit Evropian; 7. të rregullojnë aspektin ligjor të brendshëm të kompanive, duke përfshirë strukturën organizative dhe të marrëdhënieve me palë të treta; 8. dhe të jenë të aftë të përfaqësojnë kompanitë në mekanizmat shtetërorë dhe në mekanizmat alternativë të zgjidhjes së kontesteve tregtare midis tyre.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	1/13	39
Ushtrime teorike/laboratorike	/	/	/
Punë praktike	1	1/3	3
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	1/15	7.5
Ushtrime në terren	1.5	1/1	1.5
Kolokiume seminarë	1	1/6	6
Detyra të shtëpisë	1	1/2	2
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/4	4
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/6	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	1/1	3

Projektet, prezantimet, etj.	3	1/1	3
Totali	3 ECTS	Total	75
Metodologjia e mësimdhënies:	Prezantimi i temës mësimore në ligjërata bëhet përmes Power Point-it, diskutimeve interaktive, demonstrimeve. Përsëritja e temës paraprahe nga grupi i caktuar i studentëve, analiza, hulumtime dhe prezantime individuale dhe grupore. Rast studimi apo detyrë lidhur me temën e ligjëruar.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Për vlerësimin e studentëve, mësimdhënësi do të ketë në konsideratë këto kritere.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi i vazhdueshëm:</u></p> <p>Pikët në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi individual.....5 pikë; - Prezantimi dhe puna grupore.... ..5 pikë; - Punimi seminarik.....10 pikë; - Testi i parë 40 pikë; - Testi i dytë 40 pikë. <p>Studentët që arrijnë rezultat pozitiv përmes vlerësimit të vazhdueshëm, lirohen nga provimi.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi në provimin final:</u></p> <p>Studentët që nuk arrijnë sukses përmes vlerësimit të vazhdueshëm, hyjnë në provimin final. Provimi final ka gjithsej 80 pikë, kurse 20 pikët e cekura më lartë arrihen nga: Prezantimi individual - 5 pikë; Prezantimi dhe puna grupore - 5 pikë; Punimi seminarik - 10 pikë. Të gjitha këto pikë numërohen dhe transferohen në provimin final.</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Phillip Lipton & Abe Herzberg & Michelle Welsh: <i>“Understanding company law”</i>. Twentieth Edition LAWBOOK CO. 2020. - Eva Micheler: <i>“Company Law a real entity theory”</i>. First Edition published in 2021. - Michael Quilter: <i>“Company Law Perspectives”</i>. Fourth Edition Lawbook co. 2020. 		
Literatura shtesë:	- Mehdi J. Hetemi: <i>“Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut”</i> , Prishtinë, 2005.		

- Beate Sja fjell & Benjamin J. Richardson: “*Company Law and Sustainability Legal Barriers and Opportunities*”. Cambridge University Press 2015.
- Ann Ridley & Chris Shepherd: “*Key facts key cases Company Law*”. First Edition published in 2015.
- Christoph Teichmann: “*The Company Law Package – Content and State of Play*”. Brought to you by | University Library of Southern Denmark - Syddansk Universitetsbibliotek Authenticated. ECFR 2019, 3-14.
- Bartłomiej Kurcz & Athanasios Paizis: “*Company Law, Connecting Factors and the Digital Age – A New Outlook*”. Brought to you by | Göteborg University - University of Gothenburg Authenticated. ECFR 2019, 434–456.
- Edited by Mathias Siems & David Cabrelli:” *Comparative Company Law- A Case-Based Approach*”. First published in Great Britain 2018.
- Andreas Cahn & David C. Donald, “*Comparative Company Law*”. Cambridge University Press (September 6, 2010), ISBN-10: 0521143799, ISBN-13: 978-0521143790.
- Brenda Hannigan: “*Company Law*” 3rd ed (OUP, 2012).
- Andrew Hicks & SH Goo: “*Cases and Materials on Company Law*” 7th ed (OUP, 2011) or earlier edition.
- Gary B. Born:” *International Commercial Arbitration*”.*Volume II*”. Kluwer Law International 2009.
- Valbon Mulaj, “Protection of Competition from Abuse with Dominant Positions and Anticompetitive Agreements in the Kosovo Market”, *Studia Iuridica Lublinensia* 31, no. 2 (2022): 207-227.
- Valbon Mulaj. “*The advantages and disadvantages of arbitration in relation to the regular courts in Kosovo*”. Journal: Hungarian Journal of Legal Studies, 2018, Vol. 59, no. 1.
- Valbon Mulaj: “National Legal Regulation of Arbitration in the Republic of Kosovo.” *Int'l Bus. LJ* (2015): 15-38.
- Materiale të përgatitura ose të përmbledhura nga profesori i lëndës, dhe të dorëzuara më kohë, që lejon hapësirë të mjaftueshme për studim përpara ligjëratës përkatëse.
- Raste të përgatitura nga Profesori.

*Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës:
Ligji për Shoqëritë Tregtare.*

	<p><i>Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës.</i> <i>Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit.</i> <i>Ligji për Investime të Qëndrueshme.</i> <i>Ligji për Tregtinë e Brendshme.</i> <i>Ligji për Tregti me Jashtë.</i> <i>Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.</i> <i>Ligji për Markat Tregtare.</i> <i>Ligji për Gjykatën Komerciale.</i> <i>Ligji për Arbitrazhin.</i> <i>Ligji për Ndërmjetësimin.</i> <i>Ligji për Falimentimin.</i> <i>Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<p>Prezantimi i lëndës, i literaturës, si dhe i rregullave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vështrime të përgjithshme mbi lëndën: E Drejta e Kompanive; • Hyrje në ligjet kryesore të cilat rregullojnë kompanitë në Kosovë; • Hyrje në aktet kryesore juridike të Bashkimit Evropian.
<i>Java e dytë:</i>	<p>Tema: Kompania dhe fushëveprimi i saj</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimi, roli dhe rëndësia e kompanive në treg; • Analiza kryesore ekonomike e rregullimit të kompanive; • Kompanitë si persona juridikë: nocioni dhe kuptimi; • Natyra dhe karakteristikat e kompanisë; • Llojet e kompanive; • Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë; • Krahasimi me llojet e tjera të shoqërive tregtare.
<i>Java e tretë:</i>	<p>Tema: Procedura për regjistrimin e kompanive</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kushtet dhe kriteret e kërkuara më ligj për regjistrimin e kompanive; • Institucioni kompetent për regjistrimin e kompanive - Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë; • Dokumentacioni i kërkuar për regjistrimin e kompanive; • Emri zyrtar; • Ndryshimi i të Dhënave në Regjistër; • Çregjistrimi i Kompanisë në Institucionin kompetent të regjistrimit dhe Procedura ankimore.
<i>Java e katërt:</i>	<p>Tema: Akti i Themelimit dhe Statuti i Kompanisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dallimi midis kompanive që janë persona juridikë dhe kompanive që nuk janë persona juridikë;

	<ul style="list-style-type: none"> • Nocioni i Përgjegjësisë së Kufizuar - çfarë nënkupton, si aplikohet, dhe te cilat kompani zbatohet; • Qëllimi i themelimit, të drejtat dhe përgjegjësitë, aktivitetet ekonomike; • Aksionet, ndarja e aksioneve, blerja dhe shitja e aksioneve, të drejtat e votës; • Kapitali dhe relacioni me aksionet; • Kuvendi i aksionarëve, Bordi i drejtorëve, Drejtori, dhe punonjësit.
<i>Java e pestë:</i>	<p>Tema: Përgjegjësia Korporative</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përgjegjësia e kufizuar dhe e pakufizuar e kompanive; • Detyrat fiduciare të Bordit të drejtorëve dhe Drejtorit; • Raporti midis Aksionarëve (pronarëve) dhe Menaxhmentit (të Bordit të drejtorëve dhe të Drejtorit menaxhues); • Kufizimi i fuqisë së menaxhmentit.
<i>Java e gjashtë:</i>	<p>Tema: Menaxhmenti i Kompanisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtori dhe punonjësit dhe organizimi i tyre; • Roli dhe kompetencat e aksionarëve (pronarëve); • Roli dhe kompetencat e Bordit drejtorëve - duke përfshirë edhe mënyrën e zgjedhjes; • Drejtori menaxhues; • Rregullorja e punës, caktimi i pozitive, hapja e konkurseve, punësimi, largimi, pensionimi etj.; • Auditimi, menaxhimi financiar dhe aspekti ligjor.
<i>Java e shtatë:</i>	Testi I
<i>Java e tetë:</i>	<p>Tema: Bashkimi dhe ndarja e kompanive</p> <ul style="list-style-type: none"> • Një analizë për tjetërsimin e aksioneve si model i ndryshimit të pronësisë së kompanive (korporatave); • Bashkimi dhe ndarja e kompanive; • Kontratë për bashkimin e kompanive; • Kontrata për shitjen e kompanisë.
<i>Java e nëntë:</i>	<p>Tema: Analizë e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe e Shoqërisë aksionare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Natyra e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe e Aksionit; • Natyra e Shoqërisë aksionare dhe e Aksionit; • Parimi i përgjegjësisë; • Përgjegjësia për veprimet e themeluesve - para regjistrimit; • Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar;

	<ul style="list-style-type: none"> • Aksionarët e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar; • Shpërndarja e dividendave; • Qeverisja dhe menaxhimi.
<i>Java e dhjetë:</i>	Tema: Marrëdhëniet e punës me palët e treta <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e punës; • Pronësia intelektuale; • E drejta e konfidencialitetit.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Tema: Likuidimi dhe falimentimit <ul style="list-style-type: none"> • Fillimi i procedurës së likuidimit; • Përgjegjësitë ndaj kreditorëve; • Roli i likuidatorit dhe Gjykatës.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Tema: Zgjidhja e kontesteve tregtare në Gjykatën komerciale <ul style="list-style-type: none"> • Zgjidhja e kontesteve midis dy kompanive në Gjykatën komerciale.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Tema: Mekanizmat alternativë të zgjidhjes së kontesteve tregtare midis dy kompanive <ul style="list-style-type: none"> • Zgjidhja e kontesteve midis dy kompanive me ndërmjetësim; • Zgjidhja e kontesteve midis dy kompanive me arbitrazh.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Testi II
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Tema: Përmbledhje e lëndës.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Studenti/ja duhet të jetë i/e ndërgjegj-shëm/shme dhe të respektojë institucionin, statutin dhe aktet e tjera ligjore të UP-së; duhet të respektojë orarin e ligjëratave; të marrë pjesë dhe të jetë aktiv në orën mësimore; student-i/ja është i/e obliguar ta posedojë me vete ID kartelën në teste dhe provim final; gjatë hartimit të punimeve seminarike, student-i/ja duhet t'u përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit; testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student/e. Prandaj, studentët duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale. Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform akteve ligjore të UP-së.</p>	